



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 44 / 4 Prot.

Tiranë më 17.11.2022

V E N D I M

Nr. 118 / 1, datë, 17. 11. 2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Xhafer Muha, dëgjoji pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.892/6 ex-21 datë 23.09.2022, “Për proçedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Xhafer Muha”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numër protokoll 44, datë 23.09.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.118, datë 07.10.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Xhafer Muha, për kryerjen e shkeljes disiplinore në formën :

“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”,

parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, neni 33, pika 2, gërma “a”.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për propozimin për fillimin e proçedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Xhafer Muha, gjatë hetimit të 18 proçedimeve penale,

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për proçedinin disiplinor, u provua se:

2.1 Prokuroria e Përgjithshme, mbi bazën e Urdhërit Nr.61 datë 02.06.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ushtruar kontroll mbi treguesit e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vitin 2021.

Objekti i kontrollit ishte ligjshmëria e veprimeve hetimore të oficerëve të Policisë Gjyqësore në;

- Procedimet penale të regjistruara nga data 01.05.2020 – 31.05.2021 dhe ato të mbartura nga vitit 2019, për të cilat është vendosur pushimi i procedimit penal, janë dërguar për gjykim, apo nuk kanë përfunduar hetimet dhe janë mbartur për vitin 2021.

- Mosfillimet e procedimeve penale të vendosura për materialet kallëzuese/referuese të regjistruara prej datës 01.05.2020 – 31.05.2021.

- Disiplina në punë.

Nga ana e grupit të punës, në përfundim të procesit të kontrollit të ushtruar për cdo oficer të policisë gjyqësore, është përpiluar raporti përfundimtar përmbledhës në të cilantjanë pasqyruar problematikat si në nivel organizativ të punës së seksionit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ashtu dhe në nivel individual për secilin oficer të policisë gjyqësore.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar për periudhën objekt inspektimi u konstatua se, në hetimin e procedimeve penale të hetuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, në 18 prej tyre janë lejuar zvarritje në hetim dhe nuk janë respektuar afatet e caktuara në urdhërin e prokurorit të çështjes, për kryerjen e veprimeve hetimore.

Zvarritjet e veprimeve hetimore janë të pajustificuara dhe në shkelje të dispozitave ligjore të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat rregullojnë dhe disiplinojnë hetimin dhe afatet e tij.

2.2. Sikurse rezulton nga aktet e administruara në seancën dëgjimore, në datën 21.03.2019, Prokuroria Elbasan ka regjistruar **proçedinin penal Nr. 572**, për veprën penale “Shpërdorimi detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar datë 09.03.2020

Për këtë proçedin penal konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara, nga prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha për 1 vit. Fillimisht proçedimi penal është ndjekur nga oficeri i Policisë Gjyqësore i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Më pas, me vendim të prokurorit, në datën 17.04.2019, procedimi penal i ka kaluar oficerit të Policisë Gjyqësore, Xhafer Muha. Rezulton se pas marrjes së procedimit penal, oficeri Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, ka zvarritur hetimet dhe për gati 10 muaj, deri në datën 10.02.2020, kur ka përpiluar relacionin përfundimtar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Nga aktet e dosjes rezulton se nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha nuk janë kryer veprime të mirfillta hetimore, por ato janë përqëndruar pothuajse vetëm në dërgimin e shkresave institucioneve të ndryshme. Edhe në përpilimin dhe dërgimin e shkresave ka ndërpreje të gjata kohore nga një veprim në tjetrin, të pajustificuara. Nga aktet e dosjes rezulton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, janë përpiluar dhe dërguar disa shkresa në muajin prill 2019. Mandej deri në muajin korik 2019 nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Në muajin korik 2019 janë dërguar disa shkresa të tjera dhe në vijim, deri në datën 09.12.2019 nuk janë kryer veprime hetimore.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për një periudhë të gjatë kohe.

2.3. Në datën 01.04.2019, është regjistruar procedimi penal **nr. 648**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar datë 30.04.2020

Procedimi penal është regjistruar në datën 01.04.2019, ndërsa relacioni përfundimtar është përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 17.04.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara, nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha për 1 vit.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 02.04.2019, duke caktuar afat për kryerjen e këtyre veprimeve datën 20.06.2019. Afati i caktuar në urdhër nuk është respektuar dhe dosja hetimore është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha edhe për 9 muaj.

Nga aktet e dosjes dhe dokumentat e paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha rezulton se për këtë procedim janë kryer veprime, por ato nuk përbëjnë veprime të mirfillta hetimore. Veprimet janë përqëndruar pothuajse vetëm në dërgimin e shkresave institucioneve të ndryshme. Edhe në përpilimin dhe dërgimin e shkresave ka ndërpreje të gjata kohore nga një veprim në tjetrin, të pajustificuara. Nga aktet e dosjes rezulton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, janë përpiluar dhe dërguar disa shkresa në muajin prill 2019. Mandej deri në muajin nëntor 2019 nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe në vijim, deri në datën 25.02.2020 nuk janë kryer veprime hetimore.

Në rrethana të tilla, oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, ka shkelur afatet eaktuara nga prokurori në urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për një periudhë të gjatë kohe.

2.4. Në datën 10.10.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 2038, datë 10.10.2019**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar datë 12.10.2020, kërkuar pushimi i çështjes në datën 12.10.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim për afro 1 vit. Prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 14.10.2019. Nga ky moment procedimi penal është mbajtur në dorë nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha. Rezulton se procedimi penal është regjistruar në datën 10.10.2019, ndërsa relacioni përfundimtar është përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 08.10.2020. Veprimet

hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim për 10 muaj.

Për sa më sipër, evidentohet se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 10 muaj.

2.5 Në datën 27.08.2018 është regjistruar **procedimi penal nr. 1477**, për veprat penale "Fshehja e të ardhurave", dhe "Mospagimi i taksave dhe tatimeve", parashikuar nga nenet 180 e 181 të K.Penal, pushuar 21.09.2020

Konsatotohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim nga prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha për 2 vjet. Procedimi penal është regjistruar në datën 27.08.2018, ndërsa relacioni përfundimtar është përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 18.09.2020. Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 27.08.2018. Nga ky moment procedimi penal është mbajtur në dorë nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha për një kohë të gjatë, tej afatit të caktuar nga prokurori.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim për 2 vjet. Gjithashtu konstatohet se midis veprimeve hetimore nga distanca të gjata kohore. Nga aktet e dosjes rezulton oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha ka kryer veprime hetimore në muajin nëntor 2018, mandej veprimi tjetër është kryer në datën 30.05.2019, ka një veprim në datën 06.07.2020 dhe veprimi i fundit hetimor në datën 18.09.2020.

Në këto rrethana, evidentohet se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.6 Në datën 27.11.2018 është regjistruar **procedimi penal nr. 2217**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar datë 10.02.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim për 2 vjet. Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 27.11.2018, duke lënë afat për kryerjen e veprimeve datën 28.02.2019. Rezulton se nuk është respektuar afati i caktuar nga prokurori dhe procedimi penal është mbajtur në dorë nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha tej këtij afati. Gjithashtu konstatohet se që nga muaji maj 2019 deri në muajin korrik 2020 nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga oficeri i policisë gjyqësore Xhafer Muha. Në muajin korrik 2020 është kryer një veprim hetimor, është kërkuar një informacion nga Bashkia Librazhd. Pra për një periudhë 1 vit e 2 muaj nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Për sa sipër rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.7 Në datën 02.11.2018 është regjistruar **procedimi penal nr. 2010**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar datë 25.03.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim për afro 2 vjet. Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 02.11.2018, duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 25.02.2019. Nga ky moment procedimi penal është mbajtur në dorë nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha. Rezulton se procedimi penal është regjistruar në datën 02.11.2018, ndërsa relacioni përfundimtar është përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 13.07.2020. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim për 2 vjet.

Për sa më sipër, evidentohet se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 2 vjet.

2.8 Në datën 15.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1357**, për veprat penale "Shpërdorimi detyrës", dhe "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga nenet 248 e 289 të Kodit Penal, pushuar datë 11.05.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mos vijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 1 vit e 10 muaj.

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 24.07.2019, duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 30.09.2019. Pavarësisht pretendimeve të oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, konstatohet se nuk është respektuar ky afat.

Nga aktet e dosjes rezulton se të gjitha veprimet janë kryer gjatë muajit Korrik 2019 (kërkim dhe admintrim të dhënash, keqyrje vendi dhe sendi, sekuestrim, vendim ekspertimi, pyetje deklaruesi), si dhe është marrë një deklarami në muajin Nëntor 2019. Gjatë gjithë periudhës tjetër që dosja është mbajtur në hetim, nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor duke lejuar zvarritje të pajustificuara të hetimit të kësaj çështje.

Për sa sipër rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.9 Në datën 22.05.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 996**, për veprën penale 'Fshehja e të ardhurave', parashikuar nga neni 180 i K.Penal, pushuar 28.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 1 vit e 7 muaj.

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 23.05.2019, duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 23.08.2019. Pavarësisht pretendimeve të oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, konstatohet se nuk është respektuar ky afat.

Nga aktet e dosjes rezulton se të gjitha veprimet e para hetimore janë kryer në datën 24.06.2019 deri në datën 18.07.2019. Nga data 18.07.2019 deri në datën 21.02.2020, ku është kërkuar informacion nga DRT Elbasan, nuk është kryer asnjë veprim hetimor, mbajtur dosjen pe veprime për 7 muaj. Gjithashtu, nga data 03.03.2020, kur është administruar përgjigja e ardhur

nga DRT Elbasan, deri në muajin shtator 2020, për 6 muaj nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Për sa sipër rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.10 Në datën 19.02.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 342**, për veprat penale ‘Fshehja e të ardhurave’, ‘Prodhimi i kundraligjshëm i artikujvedhe mallrave industrial dhe ushqimore’ dhe ‘Fallsifikimi i vulave, i stampave ose formularëve’, parashikuar nga nenet 180, 288/a e 190 të K.Penal, dërguar gjyqit në datën 11.02.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 2 vjet.

Rezulton se për këtë proçedim penal janë kryer veprime hetimore nga oficerët e policisë gjyqësore Laureta Fusha dhe Xhaferr Muha, në kuadër të dy procedimeve penale respektive të cilat janë bashkuar në një proçedim penal të vetëm. Vendimi për bashkimin e proçedimeve mban datën 11.10.2019. Pas vendimit të bashkimit të procedimeve penale, rezulton se nuk është kryer ndonjë veprim të hetimor. Veprimet e fundit hetimore janë kryer gjatë muajit Korrik 2019. Pas kësaj periudhe nuk janë kryer veprime të tjera hetimore. Sikurse rezulton nga aktet e dosjes, nga muaji korrik 2019, deri në muajin Tetor 2020, për një periudhë prej 1 vit e 3 muaj, nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Në rrethana të tilla rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.11 Në datën 19.03.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 555**, për veprat penale të parashikuara nga nenet 135, 164, 174, 186 dhe 277 të K.Penal, pushuar 31.03.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 2 vjet.

Rezulton se në këtë proçedim penal janë regjistruar tre proçedime penale, të cilat janë ndjekur nga oficeri i Policisë gjyqësore Xhafer Muha. Konstatohen periudha të gjata kohe pa u kryer veprime hetimore. Për periudhen Mars 2019 deri në muajin Maj 2020, kohë kur është kryer veprimi hetimor i kqyrjes së vendeve, nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Për mbi një vit nuk rezulton të jete kryer ndonjë veprim hetimor në lidhje me këtë çështje penale.

Gjithashtu dhe për periudhen Maj – Korrik 2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor. E njëjta situatë edhe për periudhën Tetor 2020 – Mars 2021, ku nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Për sa sipër oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.12. Në datën 15.01.2020 është regjistruar **procedimi penal nr. 70**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, moskompetencë datë 28.04.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 1 vit e 3 muaj.

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 15.01.2020, duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 15.04.2022. Pavarësisht pretendimeve të oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, konstatohet se nuk është respektuar ky afat.

Rezulton se që nga momenti i delegimit të veprimeve hetimore oficerit të policisë gjyqësore, Xhafer Muha, janë kryer vetëm dy veprime hetimore, janë përpiluar dy shkresa adresuar DRSHTRR dhe kallëzuesit, shoqërisë përmbarimore "Kodra Bailiff Service" shpk si dhe i është marrë një deklarinim kallëzuesit. Nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor. Procedimi penal është mbajtur në hetim tej çdo afati ligjor, mbi 1 vit e 3 muaj.

Në rrethana të tilla oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm

2.13. Në datën 31.05.2018 është regjistruar **procedimi penal nr. 946, datë 31.05.2018**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar 02.04.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 3 vjet.

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 01.06.2018 duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 01.09.2018. Rezulton se nuk është respektuar afati i caktuar nga prokurori. Pavarësisht pretendimeve të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, veprimet hetimore të kryera, nuk janë të tilla që të justifikojnë mbajtjen e dosjes në hetim tej çdo afati të arsyeshëm, për tre vjet.

Për sa sipër oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.14. Në datën 21.12.2018 është regjistruar **procedimi penal nr.2368**, për veprat penale të parashikuar nga nenet 186 e 248 të K.Penal, pushuar 08.06.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 2 vjet e 5 muaj.

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 26.12.2018 duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 20.04.2019. Rezulton se nuk është respektuar afati i caktuar nga prokurori. Pavarësisht pretendimeve të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, veprimet hetimore të kryera, nuk janë të tilla që të justifikojnë mbajtjen e dosjes në hetim tej çdo afati të arsyeshëm, për 2 vjet e 5 muaj.

Për sa sipër oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.15. Në datën 26.02.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 405**, për veprat penal të parashikuara nga nenet 186 e 248 të K.Penal, pushuar 25.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore dhe mbajtjen e dosjes pa veprime për periudha të gjata kohe

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 27.02.2019 duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 20.05.2019. Rezulton se nuk është respektuar afati i caktuar nga prokurori dhe procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për dy vjet.

Veprimet hetimore të kryera, nuk janë të një shkalle të lartë vështirësie që të justifikojnë mbajtjen e dosjes në hetim tej çdo afati të arsyeshëm, për gati 2 vjet.

2.16. Në datën 21.06.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1220**, për veprat penale të parashikuara nga nenet 199/a, 248 i K.Penal, pushuar 22.05.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore dhe mbajtjen e dosjes pa veprime për periudha të gjata kohe

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 21.06.2019. Pas nxjerjes së urdhërit dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha pa shkaqe të arsyeshme për afro dy vjet.

Veprimet hetimore të kryera, nuk janë të shumta në numër dhe të një shkalle të lartë vështirësie që të justifikojnë mbajtjen e dosjes në hetim tej çdo afati të arsyeshëm, për gati 2 vjet.

Në këto rrethabna, oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime tej çdo afati të arsyeshëm.

2.17. Në datën 30.07.2020 është regjistruar **procedimi penal nr. 1234**, për veprën penale "Shpërdorimi detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pushuar datë 24.06.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore dhe mbajtjen e dosjes pa veprime për periudha të gjata kohe

Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 30.07.2020 duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 30.11.2020 Rezulton se nuk se nuk është respektuar afati i caktuar nga prokurori dhe procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme për 11 muaj.

Veprimet hetimore të kryera, nuk janë të shumta në numër dhe të një shkalle të lartë vështirësie që të justifikojnë mbajtjen e dosjes në hetim për 11 muaj.

Në këto rrethabna, oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa shkaqe të arsyeshme për 11 muaj.

2.18 Lidhur me **2** proçedime penale, të cilët përfshihet në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm , në grupin e proçedimeve penale për të cilat kërkohet proçedimi disiplinor, Komisioni nuk konstaton zvarritje në hetimin e këtyre proçedimeve penale, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha .

Komisioni i Policisë Gjyqësore, pas administrimit të provave të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, arriti në përfundimin se në proçedimet penale, **nr.1031**, regjistruar në datën 29.06.2017 dhe **nr.786** i vitit 2019, nuk evidentohen veprime apo moveprime të tij që pasjellin zvarritje në hetimin e këtyre proçedimeve penale. Zvarritjet në hetim për këto proçedime penale nuk kane ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha., por për shkaqe të tjera.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shpjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, provohet se gjatë hetimit të **16** proçedimeve penale, të trajtuara më lart, nga ana oficerit të policisë gjyqësore Xhafer Muha, janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale, që disiplinojnë afatet e hetimit dhe dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorit. Sikurse rezulton nga aktet e dosjeve penale të sipërcituara, shumë veprime hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdherin e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 mujor që parashikon neni 323 i K.K.Pr.Penale. Neni 323 i K.Pr.Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.”

Ndërsa në nenin 7, pika 2 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, është parashikuar detyrimi që ka oficeri i Policisë Gjyqësore për të zbatuar urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Sikurse u provua gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, për 16 proçedimet penale që u trajtuan më sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha, nuk ka respektuar afatet e hetimit dhe afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e çështjes.

4. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të prokurorit, nga oficeri i policisë gjyqësore Xhafer Muha, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, dhe nenit 7 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, mbajtja në dorë e proçedimit penal, pa kryer veprime hetimore dhe kryerja e tyre jashtë afateve të caktuara nga prokurori, përbëjnë shkelje disiplinore në formën, **“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat pasjellin zvarritje të proçeseve hetimore ”**, parashikuar nga **neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”**.

4.1. Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Xhafer Muha, nuk i pranon ato dhe shpjegon se vonesat dhe zvarritjet kanë ardhur për shkak të ngarkesës së madhe që ai ka patur në këtë periudhë, natyra e çështjeve që ka hetuar. Sipas tij, shkak është bërë dhe pandemia, kufizimi i veprimeve në këtë situatë.

Këto shpjegime dhe pretendime të oficerit të policisë gjyqësore Petrit Caku, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat e gjata në kohë, ne hetimin e procedimeve penale.

Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenit 7, pika 2, oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë detyrimin ligjor të zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Ndërsa në nenin 33, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale parashikohet detyrimi i Policisë Gjyqësore për të kryer detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe të njoftojë atë menjëherë mbi rezultatet e tyre. Për procedimet penale objekt i shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, prokurori ka caktuar veprimet hetimore që duhet të kryeshin dhe afatin brenda të cilit duhet të kryeshin nga oficeri i policisë gjyqësore, të cilat nuk janë respektuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Xhafer Muha.

Mosrespektimi afateve të caktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe prokurori, kryerja e veprimeve hetimore tej këtyre afateve, dhe mosnjoftimi i prokurorit, për rezultatet brenda afatit të caktuar prej tij, përbënë shkelje të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe zvarritje në hetim, në kuptimin që Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” jep për konceptin e zvarritjeve në hetim, të cilat sjellin si pasojë përgjegjësi disiplinore për oficerin e Policisë Gjyqësore.

Në thelb, afatet e hetimit të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale janë afate për prokurorin. Sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, përgjegjës për hetimin e çështjes është prokurori. Ai ka përgjegjësinë për ecurinë e çështjes dhe përfundimin e saj në afatet që ka caktuar Kodi i Procedurës Penale.

Oficeri i Policisë Gjyqësore veç parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, kryesisht lidhet me urdhërat e prokurorit për afatet e hetimit. Prokurori i cakton ato në bazë të një plani që ai ka për hetimin dhe përfundimin e çështjes. Për oficerin e Policisë Gjyqësore, afate të hetimit janë ato që cakton prokurori në urdhërat për kryerjen e veprimeve hetimore.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gjurmën “a”, pika 2, e nenit 33, parashikon si **shkelje të lehtë**, “veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat pasqellojnë zvarritje të proceseve hetimore”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Xhafer Muha, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljes disiplinore të kryera prej saj, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit.

Gjithashtu Komisioni i referohet dispozitave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që, për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Xhafer Muha të japë masën disiplinore **“vërejtje me shkrim”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.**

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me katër vota pro.

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Xhafer Muha, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i jepet masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”.**
2. Me këtë vendim, të njihet oficeri i policisë gjyqësore Xhafer Muha, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Xhafer Muha.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA

Munga

ANËTAR

HARI GOGO

Hogo

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO

[Signature]